

Flavjo Xhuveli ka lindur në 30 nëntor 1990, në qytetin e Fierit.

Z. Xhuveli ka kryer studimet e larta në periudhën 2009-2012 për Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Gjatë periudhës 2012-2014 ka përfunduar programet e studimit “Master në të Drejtën Publike”, po në këtë fakultet.

Z. Xhuveli ka një eksperiencë administrative mbi 5 vjeçare në fushën e auditimit publik. Prej vitit Shtatorit 2015 deri në Shtator të vitit 2020 ka ushtruar funksionin e Juristit, pranë Departamentit Juridik në KLSH, ku ka kryer një sërë detyrash, të cilat kanë përfshirë procese auditimi, kontrolle të cilësisë të dosjeve të ndryshme, dhënie të mendimeve juridike, asistencë juridike për audituesit, përpilimin e kallëzimeve penale të referuara në Prokurori dhe ndjekja e ecurisë së tyre.

Prej Shtatorit 2020 deri në Mars të vitit 2021 ka ushtruar funksionin e Kryeaudituesit në Departamentin Juridik. Aktualisht është i emëruar në funksionin e Drejtorit të Departamentit Juridik të KLSH.

Gjatë ushtrimit të funksioneve në KLSH ka marr pjesë në trajnime, kongrese, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me çështje të auditimit të jashtëm publik dhe institucioneve supreme të auditimit.

Z. Xhuveli është njohës i shumë i mirë i gjuhës angleze dhe italiane.